



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 1143 prot.

Shkodër me, 03/04/2020

**V E N D I M**

Nr. 155, datë 03.04.2020

**"PËR MIRATIMIN E PROCESIT MËSIMOR ON-LINE NË USH "LUIGJ GURAKUQI" NË SITUATEN COVID-19"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Urdhrit nr. 216, datë 01.04.2020 "Për një ndryshim të urdhrit nr.19.3.2020 'Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike, dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së COVID-19" të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; dhe në mbështetje të Statutit të USH, të Rregullores së studimeve në USH, Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" me qëllim që t'i vijë në ndihmë studentëve për të vazhduar procesin mësimor të vitit akademik 2019-2020 në situatën e krijuar nga COVID 19, me miratim qarkullues me datën 03.04.2020:

**V E N D O S I:**

1. Të zëvendësojë zhvillimin e procesit mësimor në auditor tek mësimdhënia on-line deri në përfundim të situatës të krijuar nga epidemia COVID 19 në vendin tonë.
2. Format e mësimi online që do zbatohen për realizimin e procesit mësimor janë:
  - a. leksionet,
  - b. seminarët / ushtrimet,
  - c. punimet vjetore,
  - d. projektet e kursit,
  - e. hartimi i tezës së diplomës
  - f. hartimi i tezës së doktoraturës
3. Në funksion të procesit mësimor dekanatet mund të vendosin edhe forma të tjera të mësimdhënies online, gjithmonë duke u bazuar në zhvillimin e tyre me efikasitet.

4. Kur studimi on-line për arsye objektive zgjat më shumë se 60% të orëve të plani fikuara në total, vlerësimi i vazhduar duhet të bëhet duke përdorur metoda vlerësimi on-line. Këto vlerësime dokumentohen nga pedagogët. Në raste të tjera vlerësimi i vazhduar bëhet gjatë kohës së mbetur bazuar në pikën 4 nenin 22 të Rregullores së studimeve në USH.
5. Për rregullim të mëtejshëm të këtij procesi mësimor on-line ngarkohen Dekanatet të cilët me propozime nga Departamentet, të nxjerrin vendimet për rregullimin e këtij procesi sipas specifikave të vetë fakulteteve.
6. Zhvillimi i procesit mësimor online do të bëhet sipas një mënyre të përcaktuar nga dekanati. Kur mësimi zhvillohet online pjesëmarrja e studentëve në procesin mësimor do të dokumentohet me regjistrimin e tij në platformën e ofruar nga dekanati dhe pedagogët. Gjatë këtij procesi stafi akademik dhe studentët do të kenë asistencën e IT së USH.
7. Vendimet e Dekanateve duhet të bazohen në Ligjin nr. 80, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e USH; Rregulloren e studimeve në USH duke ruajtur parimet e frymën e tyre. Gjithashtu vendimi i Dekanatit duhet të përcaktojë kriteret kryesore të platformave on-line që do përdoren për realizimin e procesit mësimor:
  - a. Mundësia (lehtësia) e përdorimit të platformës nga pjesa më e madhe (ose gjithë) e studentëve.
  - b. Mundësia e verifikueshmërisë dhe kontrollueshmërisë të zhvillimit të mësimin nëpërmjet platformës.
8. Ngarkohen Dekanatet për nxjerrjen e vendimeve përkatëse.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. dr. Adem BEKTESHI**

